

VENDIM
Nr. 63, datë 12.4.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “5GX ENERGY” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 10 mw, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË
LUSHNJË, QARKU FIER**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/1 prot., datë 9.4.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘5GX Energy’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “5GX Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 855 prot., datë 3.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “c” dhe “d”; për pikën 1.3 germat “a” dhe “c”; për pikën 2.1 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- **Germa “a”:** Aplikuesi duhet të përfshijë në objektin e veprimtarisë së tij dhe prodhimin e energjisë elektrike.

- **Germa “b”:** Aplikuesi duhet depozitojë në ERE dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k.

- Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- **Germa “b”:** Aplikuesi duhet të dokumentojë në ERE mbështetjen financiare për vlerën e mbetur të investimit.

- Pika 2.1

- **Germa “a”:** Aplikuesi duhet të bëjë saktësimet përkatëse në numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetin e instaluar të secilës, referuar kapaciteti total prej 10 mw.

- **Germa “e”**: Aplikuesi duhet të sqarojë nevojën për pajisje me një VNM të re brenda vlefshmërisë së VNM-së së mëparshme, si dhe të informojë ERE-n, në rast nëse ka filluar punimet për ndërtimi e centralit fotovoltaik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi